

DY FESTA SIMBOL TË DASHURISË DHE DITURISË

Shëruar nga Elmira MUJA

6 Mars 2011. Edhe pse një ditë me shi tregon se dimrin e kemi lënë pas. Jemi zgjuar nga gjumi i dimrit të zbehtë dhe të ftohtë, gëzojmë dhe shijojmë ngjyrat pranverore.

Çdo pranverë është një fillim i ri, me aq shumë për të parë dhe për të bërë. Me mundësi të reja duke na pritur, që të bëjmë atë që të gjitha dëshirat tona të bëhen realitet.

Pranvera që na jep shpresën e ripërtëritjes së jetës. Pranvera, stina që na bën të ndjehemi gjallë!

Në këtë fillim pranvere, Organizata e Grave Shqiptaro Amerikane “Motrat Qiriazit”, organizoi në Maestro Restorant ne Bronx, një mbrëmje për të festuar së bashku dy festa 7-8 Marsin.

Çdokush ka përvojë të ndryshme nga festat e ndryshme, dhe mënyrën e vet për ti festuar, ndaj dhe “Motrat Qiriazit”, ruajtën traditën shqiptare, për të nderuar të gjithë mësuesit që përhapin dritën e diturisë në cdo pëllëmbë arbnore.

Mësuesit janë ata që formojnë jetën tonë dhe na mësojnë vlerat e jetës, shoqërisë dhe botës që na rrethon, vlera dhe mësim, të cilat qëndrojnë me ne për gjatë gjithë jetës sonë.

Nderojmë këtë ditë, të gjitha gratë, sakrificat e tyre mbi të cilat është ndërtuar shoqëria sot.

Engjëlli i familjes është gruaja. Nëna, gruaja, apo motra. Gruaja është puthja e jetës, ëmbëlsia qetësuese e dashurisë të derdhur mbi mundimet e saj. Në fjalën e saj ka pasuri të mjaftueshme për të dhënë shpresën e për të qetësuar çdo dhimbje. Për më tepër për çdo njërin prej nesh ajo është iniciator i së ardhmes. Puthja e parë e nënës i mëson fëmijës për dashurinë, puthja e parë e shenjtë që gruaja i jep burrit i mëson atij shpresën dhe besimin për jetën, dhe dashuria dhe besimi krijojnë një dëshirë për përsosmëri dhe fuqinë për të ecur hap pas hapi, për të krijuar të ardhmen, simbol i gjallë i së, cilës është fëmija, lidhja që ruan familjen dhe brezat që vijnë.

Hirësia është në të gjitha hapat e saj, qielli në sy të saj, në çdo gjest dinjitet dhe dashuri.

Herion Mustafaraj drejtoi mbrëmjen, duke na dhuruar me interpretimin e tij vargje për nënën, ku më pas e bija e tij Dea, interpretoi kaq bukur vargje nga Nënë Tereza. Ai ftoi më pas të gjithë që të këndojmë së bashku Këngën e Nënës.

Fjalën e mirëseardhjes për të pranishmit e mori Presidentja e Organizatës së Grave Shqiptaro-Amerikane “Motrat Qiriazit”, Dr. Anna Kohen.

Të dashura nëna dhe motra, gra e vajza të të gjitha moshave dhe profesioneve!

Duke ju uruar mirëseardhjen, ju falenderoj nga zemra që zgjodhët vatrën e “Motrave” për të festuar së bashku dy festa, shumë domethënëse, 7 Marsin festën e mësuesit dhe 8 Marsin Ditën Ndërkombëtare të Grave.

Motrat Qiriazit, mbi emrin e të cilave është ngritur dhe fuqizuar organizata jonë, janë simboli i edukimit dhe emancipimit të gruas shqiptare. Dhe ne si pasuese të rrugës dhe punës së tyre i kujtojmë vazhdimisht me respektin më të madh. Pak kohë më parë ne festuam 3 vjetorin e Pavarsisë së Kosovës. Rroftë Kosova e lirë, demokratike dhe e pavarur!

Të nderuara mësuese!

Tek ju ne shohim prindin e dytë . Rrallë dikush mund të ndikojë në jetën e një personi në mënyrë pozitive gjatë gjithë jetës së tij, se si një mësues mund. Nxitjen e optimizmit dhe besimit, dhënien e njohurive që të çon në sukses. Të gjithë nxënësit shohin tek ju modelin e inspirimit. Mësues është profesioni më i bukur, sepse ai mëson të gjitha profesionet e tjera. Ndikimi i mësuesit është i përjetshëm. Mësuesit e cdo brezi qofshin kanë mijëra njerëz, që i kujtojnë atë për gjatë gjithë jetës së tyre.

Motra të dashura,

Të gjitha ju që vini nga drejtime të ndryshme, sot, në këtë fillim pranvere dukeni si lule., madje edhe më të bukura.

Bukuria shihet në sytë e tuaj, sepse ato janë porta e zemrës - vendit ku dashuria banon.

Gratë shqiptare, të bukura, të mëncura, të zonja dhe të afta në çdo aspekt të jetës., brenda tyre është fuqia për të krijuar, ushqyer dhe transformuar. Nëse, ne nuk bëjmë ndryshimin, nuk rritemi, nëse ne nuk rritemi, ne, me të vërtetë nuk jetojmë

Ne vetë jemi dëshmitare, se beteja për të drejtat individuale të grave janë një rrugë e gjatë dhe plot sfida. Kurrë të mos dorëzohemi nga përpjekja për të bërë atë që vërtetë dëshirojmë të bëjmë. Ku ka dashuri dhe frymëzim, unë mendoj nuk asgjë që mund të shkojë keq.

Një atmosferë me të vërtetë festive, solli grupi i valleve të Kishës Zoja e Shkodrës, në interpretimn e valleve me motive tropojane.

GRUAJA E VITIT 2011 ----- ANGJELINA NIKA

Të gjithë në komunitetin shqiptar të New Yorkut, por dhe jashtë tij, ka parë jo vetëm në skenë, por dhe në festivale apo festime të ndryshme, interpretimin me profesionalizëm nga amatorë, të dhjetra e dhjetra valle me motive nga të gjitha trevat shqiptare, të grupit të Kishës “Zoja e Shkodrës. Shumëkush nga ato nuk e dinë se arritjet e këtij grupi në përsosmëri janë meritë e pazevendësueshme e talentit, shpirtit krijues dhe të palodhur të Angjelina Nikës. Krenaria e Angjelinës qëndron në çmimet që grupi i valleve ka marrë në festivale të ndryshme.

Prej shtate vitesh Angjelina jep mësimë korografie në Kishën Katolike “Zoja e Shkodrës”.

Duke qenë bashkëshorte e njërit nga artistëve më të njohur të botës shqiptare, Gëzim Nika, ata formojnë së bashku një album historik si dëshmi e përfaqësimit të kulturës shqiptare në botë. Të dy së bashku, dhe në mbështetje të njëri tjetrit, ata i kanë dhënë një fizionomi të plotë grupit artistik të Kishës Katolike “Zoja e Shkodrës”. Me këta artistë të rinj, që Angjelina i konsideron të mrekullueshëm, që janë nga mosha 4 deri 22 vjeç, ajo ka përfaqësuar kulturën shqiptare në festalet e komuniteteve në New York dhe më gjërë. Bashkëshortët Angjelina dhe Gëzim Nika kanë tre fëmijë dhe jetojnë në Brooklyn, New York.

Prezantimin, për dhënien e cmimit GRUAJA E VITIT e bëri, Konsullja e Përgjithëshme e Republikës së Kosovës në New York, Zonja Arta Rama.

Fjalën e saj, Zonja Arta Rama e nisi duke falenderuar “Motrat Qiriazit” për ftesën e bërë dhe më pas shtoi: Ne shqiptarët kemi shumë festa, ato historike, të betejave dhe të luftës, por ne sot festojmë njëkohësisht dy festa që i kujtojmë me dashuri dhe respekt të madh. Në vitin 2002 unë bëra një praktikë pune tek “Motrat Qiriazit”. Aty pashë nga afër punën që ato bëjnë në dobi të komunitetit shqiptar, tani ne këtu shohim rezultatet e tyre. Kam nderin e vecantë të prezantoj GRUAN E VITIT, zonjën Angjelina Nika.

Ndërsa merr në dorë mirënjohjen, Angjelina thotë: Ndihej e nderuar dhe e emocionuar në këtë mbrëmje për vlerësimin e vecantë që më është bërë nga një organizatë prestigjioze “Motrat Qiriazit”, e njohur tashmë në hapsirën shqiptare dhe më gjërë për angazhimin serioz e profesional në promovimin e vlerave të qytetërimit njerëzor. Dua të ndaj sonte këtë nder dhe gëzim me disa kolegë e familjarë të mi të afërt, të cilët më kanë mbështetur dhe mundësuar të realizoj një ëndërr në atdheun e lirisë, vendin ku jetojmë, të vlerësuar si qytetarë të lire, SHBA. Dua të falenderoj, një lider fetar, shumë i njohur në komunitetin tonë, i cili ka bërë aq shumë në promovimin e kulturës dhe traditës shqiptare në këtë anë të Atlantikut, vizionarin, Dom Pjetër Popaj. Dhe sigurisht një falenderim special, për familjen time dhe bashkëshortin tim Gëzim Nika që më frymëzon pa mëdyshje në karrierën time profesionale. Ne jemi njohur e dashuruar që kur ishim shumë të rinj, dashuronim artin dhe kulturën shqiptare, traditë që e mbajmë të gjallë edhe sot.

MËSUESI E VITIT 2011, MIRJANA LUKIC-KIM

Mirjana Lukiç Kim është një shqiptare që ka emigruar nga Ulqini i Malit të Zi në fillim të viteve 1970 me prindërit e saj. Znj Lukiç-Kim u rrit në Bronx dhe ndoqi shkollën fillore ku ajo aktualisht është mësimdhënëse e gjuhës angleze si gjuhë e dytë. Për 21 vitet e fundit, Znj, Lukiç-Kim ka qenë aktive në familje servisin shqiptare brenda komunitetit të shkollës.

Znj. Lukiç-Kim mëson të rinjtë me prejardhje të ndryshme kulturore në Shkollën Publike Numer 8 në rajonin e Parkut Bedford të Bronx-it. Suksesi i saj rrjedh nga pasioni për mësimdhënie dhe përkushtimi për studentët e saj.

Znj. Lukiç-Kim punon me zell me të rriturit e kulturave të ndryshme në përpjekje të mësimin të aftësive në gjuhën Angleze dhe të edukatës qytetare. Gjatë pesë viteve të fundit, ajo ka shërbyer si Profesoreshe/Adjunct zëvendësues në Touro College në të dy qendrat e tij në Manhattan dhe Brooklyn. Znj Lukiç-Kim është diplomuar në Gjuhësi në Lehman College dhe ka përfunduar master në TESOL dhe administrim shkolle nga Kolegji i New Rochelle. Ajo banon me burrin e saj dhe dy fëmijët në Westchester.

Prezantimin e mësuese së vitit Mirjana Lukic Kim e bëri Znj. Mjaftime Dushallari.

E njoh Mirjana Lukic Kim nga afër, shtoi ndër të tjera, Zonja Mjaftime Dushallari, jo vetëm si kolege dhe mësuese e aftë profesionalisht, por edhe si shpirt bujar e fisnik. Aftësitë e saj profesionale kanë bërë të mundur që Mirjana të japë mësim jo vetëm në shkollë publike në Bronx por edhe në Touro College.

Resumeja e saj është shumë e shkurtër në krahasim me atë që Mirjana bën në realitet.

Mirjana e ngarkuar emocionalisht thotë: Faleminderit “Motra” të dashura e në vecanti Dr. Kohen që më vlerësuar me titullin “Mësuesja e vitit 2011” E ndjej veten të privilegjuar dhe si një shtysë e mirë në punën time dhe të nderuar, atë të mësuesit. Faleminderit bashkëshortit dhe dy fëmijëve të mi të mrekullueshëm.

NDERIM PËR ARTIN DHE KULTURËN SHQIPTARE

Është në traditën e veprimtarive të tilla që organizita e gruas shqiptaro amerikane “Motrat Qiriazit”, të nderojë figura dhe emra të njohur të artit shqiptar. Nisur nga kjo traditë, cmimin për arritjet gjatë viteve iu akorduar artistes së popullit Margarita Xhepa. Për arsye teknike, Margarita Xhepa, nuk arriti të vijë e të festojë së bashku me komunitetin shqiptar të New York-ut.

Më pas, të pranishmit i përshëndeti konsulli i përgjithshëm i Shqipërisë në New York, Z. Dritan Mishto, i cili premtoi se do t’ia dërgonte vetë në dorë mirënjohjen që “Motrat Qiriazit” i dedikuan artistes *Margarita Xhepa*.

Këtë mbrëmje e nderoi edhe prezenca e Zv. Ministres së Punëve të Jashtme të Shqipërisë Zonja Edith Harxhi, e cila drejtoi një përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Dua tju përshëndes jo vetëm për 8 Marsin, sepse ne shqiptarët kemi edhe ditën e Mësuesit, 7 Marsin, Për të gjithë ju që vini nga sfera e arsimit dhe që përvecse janë nëna dhe motra, por ka dhe nga ata që janë mësues. Dëshiroj gjithashtu që të vlerësoj për një rol të pa diskutueshëm për forcën e madhe që kanë në botën e tyre të gjitha ato zonja, motrat, vajzat, nënat shqiptare. Janë një forcë e padiskutueshme në zhvillimet që ka patur kombi shqiptar gjatë gjithë këtyre viteve të fundit.

Ju uroj këtë festë të mrekullueshme dhe dëshiroj që festa të tjera, sic janë këtu në New York, të ngjajnë po njësoj dhe ti zbatojmë këshillat sot, apo në ditët në vijim që në datën 8 Mars, në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Podgoricë dhe kudo. Ju faleminderit dhe gëzuar.

Këngët dhe vallet shqiptare e zbukuruan së tepërmi këtë mbrëmje.

Ndërsa muzika vazhdon me këngë të bukura shqiptare, pranë meje është Mitro Mërtiri. E ka mbërthyer nostalgjia dhe këndon. Si për ta ngacmuar e pyes se cfarë të kujton kjo këngë. Ah, më përgjigjet ai, më kujton ato vite që kurrë nuk mund ti bie mbrapsht.

Po cfarë thonë familjarët e Angjelinës dhe të Mirjanës, që gjithsesi edhe ata janë pjesë e një gëzimi të përbashkët.

Gëzim Nika: Kjo është një mbrëmje e vecantë për mua dhe familjen time. Puna që bëjnë “Motrat Qiriazit”, në komunitetin shqiptar është e admirueshme. Ndoshta, unë si individ-artist u jap pak borxh “Motrave Qiriazit”, por do t’ju shpërblej në të ardhmen.

E bija e Angjelinës, **Eliverta Nika**, thotë, jam shumë e lumtur që nëna ime u vlerësua sot me një titull që cdo kush mund ta dëshironte. Jam krenare për prindërit e mi që i japin kaq shumë kulturës shqiptare.

Jeehoon Kim, bashkëshorti i Mirjanës thotë: Ne vijmë nga kultura të ndryshme dhe është shumë mirë kur ato i ndajmë bashkë. Unë e shoh këtu se si ju shqiptarë e vlerësoni dhe e nderoni punën e mësuesit dhe të gruas në veçanti.

Ndërsa e bija e Mirjanës, **Fiona**, nuk di të zgjedhë fjalët për nënën e saj, por ajo është krenare për vlerësimin që i është bërë nënës së saj të dashur.

Në fund mbrëmja pati edhe të papriturat e saj me një mini llotari.

Që në fillim të mbrëmjes u theksua që 1,000 dollarë, nga të ardhurat e grumbulluara do ti dhurohen shkollës shqipe në Bronx dhe pjesa tjetër do të shkojë në fondin e fëmijëve.

Sergio Bitici dhuroi një pikturë, dhe fondet nga shitja e saj në formë ankandi do ti shkonë direkt AAWO në fondin për kurimin e fëmijëve të sëmurë.

Në fund me mirënjohje të madhe Organizata e Grave Shqiptaro-Amerikane “Motrat Qiriazit”, falenderon midis te tjereve:

*Herion Mustafaraj në drejtimin me mjeshtri të lartë artistike të mbrëmjes
Macelleria Restaurant, me pronarë Sergio dhe Violetta Bitici
Donika Bardha
Zana Restaurant me pronar Shaqir Gashi
Vehbi Bajrami, botuesi i Illyria-s
Albana Kaufman
Agathia dhe Ylli Luka
Albanian CultureTV me President Adem Belliu*

Grupi i valleve të Kishës Katolike drejtuar nga Angelina Nika

Zef Balaj nga Vatra

Father Nathan, Prifti dhe Bordi i Kishës Ortodokse Shqiptare në Jamaica Estates, New York.

Pa prezencën dhe bujarinë e tyre kjo mbrëmje nuk do t’i kishte përmasat e një feste të vërtetë.

New York, Mars 2011

Botuar ne gazeten “Illyria”, 8 Mars 2011